REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:003837

Datë: 16.07.2020

Numri i dokumentit: 01026146

PKR.nr.99/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE –Departamenti për Krime te Rënda Gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i trupit gjykues me pjesëmarrjen Sekretares Juridike Bute Ramosaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit SH.K. nga K- Malishevë, për shkak te veprës penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 prg 1 te KPRK-se, dhe te akuzuarit A.K. nga K- Malishevë, për shkak te veprës penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 366 prg 1 te KPRK-se, të akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Gjakovë,- Departamenti i Përgjithshëm tani Departamenti për Krime te Renda, PP/II.nr. 1396/19, të datës 05.02.2020, pas mbajtjes se shqyrtimit fillestar me datë 06.07.2020 në prezencën e Prokurorit të shtetit Ali Uka , të akuzuarve SH.K dhe A.K, **me datë 06.07.2020** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 16.07.2020 e përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

1.SH.K., nga i ati D., e ëma F., e gjinisë M., data e lindjes... ne fshatin... K- Malishevë, ku edhe tani jeton, i pa martuar punëtor, ka te kryer shkollën mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar- shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

2.A.K., nga i ati H., e ëma S., e gjinisë D., data e lindjes.... , ne fshatin K- Malishevë, ku edhe tani jeton, i pa martuar punëtor, ka te kryer shkollën mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar- shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

JANË FAJTORË

Për shkak së:

I. Për shkak se i pandehuri **Sh.K.**, me pare ka siguruar dhe me dt. 11.08.2019, ne mënyrë te kundre ligjshme ka përdor armën dhe atë një armë te tipit pistoletë " ECOL FIRAT MAGNUM " e kalibrit 9.mm, me numër serik EF 12104169, me një karikatorë dhe fishkë te kalibrit 7.62 mm, ne atë mënyrë qe ditën kritike ne oborrin e shtëpisë së tij ne fshatin ...K- Malishevë, në një aheng familjare, ne shenje te gëzimit ka përdorur armën duke shtënë 10 here ne ajër, ashtu qe pas lajmërimit te rastit, arma, karikatori dhe gëzhojat e gjetura ne vendin e ngjarjes janë sekuestruar nga zyrtaret policor.

2020:022558

- me çka ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

II. I pandehuri **A.K.** nga data e pa vërtetuar e deri ne datën 03.09.2019, ka mbajtur ne pronësi, kontroll ose posedim armë ne kundërshtim me nenin 4 prg 1 nen prg 1.1 te Ligjit mbi armët te Republikës së Kosovës dhe atë një armë gjahu e tipit " ESCORT MAGNUM " me numër serik 578646, një pushkë gjysmë automatike kalibrit 7.62 mm, me numër serik 1226 24 fishek te pushkës s e gjahut te kalibrit 12 mm, dhe një gëzhojë e kalibrit 12 mm, ashtu qe te njëjta pas bastisjes nga ana e policisë janë konfiskuar.

- me çka ka kryer veprën penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 366 prg 1 te KPRK-se.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 42, 44, 69, 70, 71 dhe 72 dhe nenit 367 par.1, dhe nenit 366 prg 1 te KPRK-së, dhe neneve 359 par.2, 366, 450 të KPPK-së të akuzuari i:

G J Y K O N:

1. Te akuzuarin **Sh.K.** për vepër penale përdorimi i armës, apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 prg 1 te KPRK-se, me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muajve, i cili dënim me pëlqimin e te akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjobe ne shume prej 8**00 (tetëqind) €**, te cilin dënim duhet ta paguaj ne afate prej 3 (tre) muajve, nga data kur ky aktgjykim te behet i formës se prere.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund te paguaj dënimin me gjobe, atëherë gjykata te akuzuarit, i kthehet dënimi me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muajve.

Ndaj te akuzuarit **konfiskohet**: pistoletë " ECOL FIRAT MAGNUM " e kalibrit 9.mm, me numër serik EF 12104169, një karikatorë dhe fishkë te kalibrit 7.62 mm, si objekte të veprës penale.

2. Të akuzuarit **A.K** për vepër penale mbajtje ne pronësi kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 366 prg 1 te KPRK-se, me dënim me gjobe ne shume prej 1000 (një mije) €, te cilin dënim duhet te paguhet ne afat prej 3 (tre) muajve, nga data kur ky aktgjykim te behet i formës së prere.

Ne rast se dënimi me gjobe nuk mund te ekzekutohet ne asnjë mënyrë siç parashihet ne nenin 43 te KPRK-se, dënimi me gjobe do te zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 50 (pese dhjete) dite, duke llogaritur nga nje dite burgimi nga 20€.

Ndaj te akuzuarit **konfiskohet**: armë gjahu e tipit " ESCORT MAGNUM " me numër serik 578646, një pushkë gjysmë automatike kalibrit 7.62 mm, me numër serik 1226 24 fishek te pushkës se gjahut te kalibrit 12 mm, dhe një gëzhojë e kalibrit 12 mm.

Urdhërohet Stacioni Policor në Malishevë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armëve dhe municionit të konfiskuar, që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2019-ED-399, te dt. 25.09.2019.

2020:022558

Detyrohen të akuzuarit, që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë me nga 50 (pesëdhjetë) €uro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit me shumën me nga 50 (pesëdhjetë) €uro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Gjakovë,- Departamenti i Përgjithshëm tani Departamenti për Krime te Renda ka ngritur aktakuzën PP/II.nr. 1396/19, të datës 05.02.2020, kundër te akuzuarit Sh.K. nga fshati ... K- Malishevë, për shkak te veprës penale përdorimi i armës, apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 prg 1 te KPRK-se, dhe te akuzuarit A.K nga fshati ... K- Malishevë, për shkak te veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 366 prg 1 te KPRK-se.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestare me datë 06.07.2020, ku prezent ka qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Ali Uka te akuzuarit Sh.K dhe A.K.

Pas leximit te aktakuzës ne seancën e shqyrtimit fillestarë, Gjykata është bindur se të akuzuarit Sh.K. dhe A.K. kane kuptuar aktakuzën, dhe veprat penale qe ju vihet ne barrë, ju është dhënë mundësia qe te deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Me këtë rast Gjykata ka udhëzuar te akuzuarit për rendësin dhe pasojat e pranimit te fajësisë kështu qe pas shpjegimeve te mjaftueshme nga ana e Kryetarit te Trupit Gjykues të akuzuarit janë deklaruar te fajshëm për veprat penale qe i vihen ne barrë sipas aktakuzës ku i akuzuari Sh.K. ka deklaruar se ditën kritike me dt. 11.08.2019, ka pasur gazmend familjare dhe shenje te gëzimit ne oborrin e shtëpisë se tij ka shtënë me arme ne ajër disa here dhe i ka propozuar Gjykatës që ti shqiptohet një dënim sa me i bute, dhe është hera e parë qe ndeshet me Ligjin.

I akuzuari A.K. ka deklaruar se pranon fajësinë për vepër penale për te cilën akuzohet duke theksuar se armët qe janë gjetur ne shtëpi me rastin e bastisjes kane qene te prindërit te tij i cili ka vdekur, dhe këto armë i ka pasur kujtim te njëjta kurrë nuk i ka keqpërdor dhe i ka propozuar Gjykatës qe ti shqiptoi një dënim sa me i bute, nga se ekzistencën e siguron nga puna si punëtor fizikë.

Pas deklarimit te akuzuarit Sh.K. dhe A.K. për pranimin e fajësisë, Kryetari i trupit gjykues kërkoj qe mendimin e vet ta jep Prokurori i Shtetit.

Prokurori i Shtetit Ali Uka, ka deklaruar: s e këtu te akuzuarit Sh.K. dhe A.K ne këtë seancë te shqyrtimit fillestar kane pranuar fajësinë për vepër penale nga aktakuza ashtu qe i akuzuari Sh.K për vepër penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 prg 1 te KPRK-se, ndërsa i akuzuari A.K. për vepër penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 366 prg 1 te KPRK-se, ashtu qe duke qene te bindur se ky pranim i fajësisë është bere pa presion te njëjtit i kane kuptuar pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë, e ky pranim i fajësisë mbështet dhe ne prova te siguruara gjate procedurës se hetimeve e te propozuara ne aktakuze ashtu qe i propozoi Kryetarit te Trupit Gjykuese q e te aprovoi pranimin e fajësisë së te akuzuarve.

2020:022558

Po ashtu i propozoi Gjykatës qe ndaj te akuzuarve te shqiptohet dënimi plotësues ti konfiskohen armët si ne dispozitivet e akuzës, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit te njëjtit te shkatërrohen.

Në shqyrtimin fillestare dhe publike Kryetari i Trupit Gjykuese pas dëgjimit të palëve, Prokurori i shtetit dhe te akuzuarve, ka marrë aktvendim me te cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarve ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 te KPPK-se. Gjatë pranimit të fajësisë Kryetari i Trupit Gjykuese konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pas shpjegimeve te mjaftueshme nga ana e Gjykatës, dhe se pranimi i fajësisë mbështet ne fakte qe i përmban aktakuza, dhe atë raporti i oficerit policor S.H. #..., te dt. 03.09.2019, procesverbali mbi kontrollit dhe banesave te dt. 02.09.2019, lista e armëve te konfiskuara te dt. 03.03.2019, deklarata e te pandehurve te cilët kane pranuar fajësinë si dhe foto dokumentacioni dhe shkresat tjera te lendes, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë rrethane e paraparë nga neni 253 par.1 dhe 2 te KPPK-se, për pushimin e procedurës përkatësisht për hudhjen e akuzës.

Andaj duke u bazuar ne këto qe u ceken me lart Kryetari i Trupit Gjykuese ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari Sh.K. me dashje ka kryer vepër penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 prg 1 te KPRK-se, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Në nenin 367 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm : *"kush do qe përdor armën apo materiale plasëse ne kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiale plasëse te tilla, dënohet me burgim prej 1 deri ne 8 vite"* .

Se i akuzuari A.K. me dashje ka kryer vepër penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 366 prg 1 te KPRK-se, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi.

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armëve : *"kush do qe mbanë ne pronësi, kontroll ose posedim ose posedon armë ne kundërshtim me Ligjin e zbatueshme lidhur me armët te tilla, dënohet me gjobe deri 7.500€, ose me burgim deri ne 5 vjet".*

Andaj duke u bazuar në këto të cekura si me lartë Kryetari i Trupit Gjykuese të akuzuarit Sh.K. e ka shpallur fajtorë për shkak te veprës penale përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 prg 1 te KPRK-se, ndërsa i akuzuarin A.K. e ka shpallur fajtor për vepër penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armeve nga neni 366 prg 1 te KPRK-se, për te cilat vepra te akuzuarit janë penalisht përgjegjës dhe janë shpallur fajtore dhe gjykuar ne baze te ligjit, duke vërtetuar përgjegjësin juridike penale te tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese Gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: në gjykim kanë pasur qëndrim tejet korrekt, pendimin e tyre, ndërsa si rrethanë

2020:022558

posaçërisht lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë ne shqyrtimin fillestarë si dhe faktin se më parë nuk kanë qenë të dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, kështu që te akuzuarit Sh.K. ja ka shqiptuar dënimin nen minimumin e parapare Ligjore, dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muajve, dhe këtë dënim me kërkesën dhe pëlqimin e tij te njëjtin ja ka zëvendësuar me dënim me gjobe, ndërsa te akuzuarit A.K. i ka shqiptuar dënimin me gjobe me shprese dhe bindje se edhe me këto dënime do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së ,dhe këto dënim si i tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Përveç dënimit kryesor Gjykata të akuzuarit komform nenit 367 par.3 , dhe nenit 366 prg 3 te KPRK-se, i ka konfiskuar armen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si objekt i veprës penale dhe më pas ka urdhëruar Stacionin Policorë në Malishevë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e kësaj arme dhe municionit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par. l të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e neni 365 par. 1 te KPPK-se është vendosur ne dispozitave te këtij aktgjykimi.

G JYKATA THEMELORE NE GJAKOVË
-Departamenti Për Krime te Rënda-
PKR.nr.90/2020 me dt.16.07.2020

Sekretare Juridike **Kryetari i trupit gjykues**
Bute Ramosaj **Shaqir Zika**

UDHEZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët e ka kënaqura mund te ushtrohet ankesa n afate prej 15 ditëve nga dita e pranimit te aktgjykimit, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

2020:022558